



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.81/2024

Datë: 29 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 5 të Rregullores Nr.04/2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (01/2014) për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve, në takimin 323-të, të mbajtur me datë 29 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Paneli për shqyrtimin e aplikacioneve, intervistimin, vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatëve për ngritje në detyrë për tre (3) gjyqtarë në Gjykatën Supreme, në përbërjen si në vijim:
 1. Fejzullah Rexhepi, kryetar i Gjykatës Supreme / kryetar i Panelit;
 2. Albert Zogaj, kryesues i KGJK-së/ anëtar i Panelit;
 3. Teuta Ibrahimimi, anëtare e KGJK-së / anëtare e Panelit;
 4. Afrim Shala, gjyqtar në Gjykatën Supreme / anëtar i Panelit;
 5. Andrijana Miletic, anëtare e KGJK-së / anëtare e Panelit;
 6. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme / anëtar rezervë i Panelit;
 7. Ahmet Imami, anëtar i KGJK-së / anëtar rezervë i Panelit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.80/2024, i datës 29 mars 2024, ka shpallur konkursin e brendshëm për tre (3) pozita të lira për gjyqtar në Gjykatën Supreme nga lëmia civile.

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtutjeshme për këtë proces, KGJK, konform nenit 5 të Rregullores Nr.04/2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (01/2024) për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të panelit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.